



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TATIMPAGUESVE
Sektori i Asistencës dhe Shërbimit për Tatimpaguesit

Nr.10748/1 Prot.

Tiranë, më 26.05.2017

Drejtuar: Z.Renaldo BREGU

Administrator

Subjekti "Përfaqësohu "

Adresa: Rruga "Muzakët", Nd.19, H.12, Nr.12 Njësia Administrative nr.9, 1016

TIRANË

Për dijeni: Ministria e Financave

Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Nr.3, TIRANË

Këshilli i Ministrave

Rr."Ismail Qemali", TIRANË

Lënda: Kthim Përgjigje

I nderuar z. Bregu,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.20 Prot., datë 10.05.2017, protokolluar me tonën Nr. 10748 Prot., datë 15.05.2017, bazuar në ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e Informimit", regjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me numër rendor 24, me lëndë: "Kërkesë për Informim, të njihemi me NUIS-i e Facebook Albania", pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, në nenin 24 dhe 25, përcakton në mënyrë të qartë autoritetet dhe rrethanat, të cilave Administratat Tatimore mund dhe duhet t'iu ofrojë, pas kërkesës me shkrim, informacion tatimor për tatimpaguesit, të administruar prej saj dhe konkretisht citojmë: "*Informacioni tatimor për tatimpaguesin, i*

Adresa: Rr. Gjin Bue Shpata

Tel: ++ 355 42276800, Fax: ++355 42276805

Web site: www.tatime.gov.al

administruar nga administrata tatimore, u ofrohet pa pagesë autoriteteve të përcaktuara në këtë nen, pas depozitimit të kërkesës me shkrim dhe kur verifikohen rrethanat e mëposhtme:

- a) gjyqtarit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje civile, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;
- b) gjyqtarit apo prokurorit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje penale, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;
- c) Kontrollit të Lartë të Shtetit, vetëm për rastet, kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga ky institucion ndaj administratës tatimore, në funksion të hartimit të rekomandimeve të veta;
- ç) autoritetit të ngjashëm të huaj, me të cilin Kuvendi ka ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare dhe informacioni kërkohet në kuadër të ekzekutimit të marrëveshjes;
- d) autoritetit homolog të huaj ose autoriteteve vendase, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe, me objekt shkëmbimin e informacionit;
- dh) institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj;
- e) çdo autoriteti tjetër, sipas parashikimit të bërë me ligj të veçantë.”

Bazuar në Ligjin nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, neni 3, QKB publikon të dhënat e regjistruara, sipas ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit, në faqen e saj zyrtare të internetit. Regjistri tregtar i subjekteve, i publikuar në <http://www.qkr.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/> është lirisht i aksesueshëm për publikun.

Ju urojmë punë të mbarë.

Me respekt

ZV/DREJTOR I PËRGJITHSHËM

XHAVIT ÇURRI

Për aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë miratuar gjithsej 500 vende për punonjës shërbimi, me një kohëzgjatje pune 8 orë/ditë për një periudhë 6-mujore dhe 16 vende për punonjës me kohë të pjesshme (4 orë/ditë vjetore), ku përfshihen, protokollist-arkivist, punonjës pastrimi, punonjës mirëmbajtjeje etj.

Punësimi i punonjësve të shërbimit është në vazhden e një projekti të zbatuar edhe gjatë vitit 2016, për vijimësinë e nismës së iniciuar nga Këshilli i Ministrave, për luftën pa kompromis kundër informalitetit fiskal në shkallë vendi dhe rolit thelbësor të administratës tatimore në këtë proces.

Aktualisht, nga më shumë se 600 aplikime të paraqitura pranë DPT dhe/ose Drejtorive Rajonale Tatimore, janë emëruar 485 punonjës shërbimi me një kohëzgjatje pune 8 orë/ditë për një periudhë 6-mujore, si dhe 15 punonjës me kohë të pjesshme (4 orë/ditë vjetore).

Ju urojmë punë të mbarë.

Me respekt

**ZV/DREJTOR I PËRGJITHSHËM
XHAVIT ÇURRI**

